



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI**

Nr.563 Prot.

Tiranë, më 09.02.2022

**KALLËZIM - PENAL**

**KALLËZUES:** **PRESIDENTI I REPUBLIKËS, ILIR META**, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë.

**KUNDËR:** **FUNKSIONARËVE PËRGJEGJËS ADMINISTRATIVË/POLITIKË NË KUVENDIN E SHQIPËRISË**

**OBJEKTI:** Kallëzimi i veprimeve të paligjshme që përmbajnë elementë të figurës së veprës penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, kryer në bashkëpunim.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;  
Neni 281 i Kodit të Procedurës Penale;  
Neni 186, i Kodit Penal;  
Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**DREJTUAR:** **PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR (SPAK)**

**PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

**Tiranë**

**PËR DIJENI:** **PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

**Tiranë**

*Të nderuar zonja/zotërinj Prokurorë,*

**I. Hyrje**

Siç mund të jeni në dijeni, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë u zhvillua procesi gjyqësor lidhur me kërkesën që Kuvendi i Shqipërisë (Legjislatura e IX-të), investoi këtë Gjykatë,

përmes vendimit **nr. 55/2021, datë 9.6.2021**, “Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës”.

Pas njoftimit prej Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Republikës në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në respekt të kërkesave të Gjykatës për këtë çështje, ka mbajtur një komunikim me Gjykatën dhe ka depozituar pranë saj që prej 1 korrikut 2021, përmes shkresës me nr. 2143 prot., datë 1.07.2021, qëndrimet, kërkimet dhe pretendimet e tij, shoqëruar me provat përkatëse.

Në funksion të zhvillimit të procesit gjyqësor, palët (Kuvend - President) duke shfrytëzuar mjetet dhe të drejtat e njohura nga ligji nr. 8577/2000, kanë depozituar prova, kanë dhënë parashtrime, shpjegime, përgjigje dhe është zhvilluar debati gjyqësor. Sipas përcaktimit të Gjykatë, të gjitha seancat gjyqësore ishin publike, të hapura. Hetimi dhe debati gjyqësor përfundoi në datën 7.2.2022, ku palët parashtruan dhe konkluzionet e tyre përfundimtare.

Presidenti i Republikës në këtë proces, përpos të tjerave, i parashtroi Gjykatës Kushtetuese pretendimet e tij mbi shkeljet flagrante, të shumta, dhe të përsëritura të Kushtetutës, të Ligjit për Komisionet Hetimore (nr. 8891/2002) dhe të Rregullores së Kuvendit të konsumuara prej Kuvendit të Shqipërisë, përmes realizimit të një procesi tërësisht të parregullt ligjor dhe që binte ndesh me gjithë parimet kushtetuese.

Këto çështje u ngritën përpara Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht për ato që kishin të bënin pikërisht dhe me shkelje të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, të konsumuara edhe nga vetë Kryetari i Kuvendit dhe Seanca Plenare.

Përpara së të kalojmë në parashtrimin e fakteve për këtë kallëzim, në mënyrë shumë të përmbledhur, citojmë disa nga parashtrimet që Presidenti i Republikës i parashtroi Gjykatës Kushtetuese, dhe që lidhen dhe me arsyen se përse Kuvendi, paraqiti prova të reja, për të cilat paraqitet ky kallëzim. Konkretisht, Presidenti i Republikës i parashtroi Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera se:

“Konkretisht mbledhja e Kuvendit në seancë plenare në **7 maj 2021** dhe përcaktimi i rendit të ditës së kësaj seance, u përcaktua me urdhrin nr. 19, datë 6.5.2021 të Kryetarit të Kuvendit, pra vetëm një ditë përpara zhvillimit të seancës. **Ky veprim bie në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, e cila në nenin 27, pika 5, përcakton se:**

*“Në çdo rast, rendi i ditës duhet të jetë bërë publik të paktën **2 ditë** përpara datës së caktuar për mbledhjen e komisionit, ose seancës plenare”.*

Kjo prezumon rregullin se përcaktimi i rendit të ditës nuk mund të bëhet **më vonë se 48 orë** përpara zhvillimit të seancës së planifikuar. Në këtë mënyrë, përveçse sa më sipër, por dhe referuar fakteve se;

- Komisioni i Çështjeve Ligjore kishte përfunduar mbledhjen e tij vetëm në datën **6 maj 2021**, kohë kjo e cila për nga përlllogaritja e afateve kohore, përkonte me një afat me më pak se 20 orë deri në zhvillimin e seancës plenare në datë 7 maj 2021, ora 10:00;
- çështja objekt shqyrtimi paraqiste një rëndësi shumë të veçantë;
- kërkesat që Presidenti i Republikës kishte paraqitur në mënyrë të përsëritur për t'u dëgjuar në Komisionin e Ligjeve nuk ishin respektuar;
- Rregullorja e Kuvendit parashikonte se rendi dhe çështja objekt shqyrtimi nuk mund t'u bëhet me dije deputetëve **më vonë se 48 orë** përpara zhvillimit të seancës së planifikuar;

bënin të detyrueshme që në rendin e ditës në seancën plenare të datës 7 maj 202, ora 10:00, Kuvendi i Shqipërisë të mos përfshinte për shqyrtim në seancë plenare çështjen e shqyrtimit të Raportit të Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe as ngritjen e Komisionit të Posaçëm Hetimor Parlamentar.

**Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka elaboruar se, Rregullorja e Kuvendit është një akt, burimi i rezervuar i së drejtës kushtetuese që disiplinon procedurën për zhvillimin e punimeve të Kuvendit, organizimin e brendshëm, raportet midis vetë Kuvendit si tërësi e organizmave të tij të brendshëm, raportet e tij me organet e tjera kushtetuese etj. Një pjesë e dispozitave të Rregullores janë në përmbajtje të njëjta me dispozitat kushtetuese, ndërsa disa të tjera janë norma ekzekutive të normave kushtetuese, pra, që përcaktojnë rregullat se si vihen në jetë normat kushtetuese.**

Në këtë mënyrë, rezulton e provuar se veç sa më sipër, **Kuvendi i Shqipërisë ka shkelur në mënyrë flagrante kërkesat e nenit 27 e vijues të Rregullores së tij e rrjedhimisht Kushtetutën e Shqipërisë.**

Një tjetër shkelje e rëndë e Kuvendit, ishte fakti se në datën 7 maj 2021, Kuvendi përveç **Vendimit nr. 44/2021, datë 7.5.2021**, “Për miratimin e raportit dhe propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut “Për ngritjen e një Komisioni Hetimor bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës”, mori edhe një vendim tjetër, pikërisht **Vendimin nr. 45/2021, datë 7.5.2021**, “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë””.

**Ngritja e Komisionit Hetimor nuk ishte e përcaktuar në rendin e ditës që Kryetari i Kuvendit kishte caktuar me Urdhrin nr.19, datë 6.5.2021, urdhër i nxjerrë ky, si më sipër i sqaruar, në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit.**

Në këtë mënyrë, në vlerësim me kërkesat e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, rezulton se Kuvendi i Shqipërisë, **ka konsumuar edhe dy shkelje të tjera flagrante të neneve të Rregullores.**

Konkretisht, të nenit **31 të Rregullores**, që përcakton procedurën se si realizohet ndryshimi i rendit të ditës të seancës plenare, përcaktohet në pikën 1 dhe 2, se:

*“1. Kuvendi ose komisionet nuk mund të diskutojnë dhe të vendosin për çështje që nuk janë në rendin e ditës.*

*2. Për të diskutuar, ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kuvendi merr vendim me jo më pak se tre të pestat e deputetëve të pranishëm. Propozimet për vendosje të çështjeve të tjera në rend të ditës duhet të paraqiten me shkrim nga të paktën 10 deputetë, nga një kryetar grupi parlamentar ose nga Këshilli i Ministrave vetëm para fillimit të seancës, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi.*

*Në rastet kur kërkesën nuk e bën grupi parlamentar, kërkesa paraqitet nga një deputet dhe grupi mbështetës i deputetëve ngrihet në këmbë.”*

**Në këtë mënyrë, rezulton e provuar se Kuvendi i Shqipërisë, veç shkeljeve të rënda si më sipër, ka miratuar Vendimin nr. 45/2021, datë 7.5.2021, “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”, jashtë çështjeve të paraqitura për shqyrtim në rendin e ditës, duke konsumuar kështu së bashku me të tjerat dhe shkeljen tjetër të rëndë të nenit 31 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.”**

Përmes kësaj veprimtarie, Kuvendi i Shqipërisë **dhunoi hapur parimin kushtetues të shtetit të së drejtës** të përcaktuar në nenin 4/1 të Kushtetutës, por njëkohësisht duke shkelur në mënyrë flagrante dhe të përsëritur Rregulloren e funksionimit të tij, **Kuvendi ka dhunuar njëkohësisht dhe nenin 75, pika 2, të Kushtetutës**, ku përcaktohet se Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.

**Duke qenë se Kuvendi i Shqipërisë, mbart detyrimin kushtetues që të organizohet dhe të funksionojë sipas Rregullores së Kuvendit, atëherë e gjithë veprimtaria dhe vendimmarrja e tij që në fazën fillestare për shkak të shkeljeve shumë të rënda të normave procedurale dhe materiale bie ndesh me këtë urdhërim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.”**

Këto ishin disa prej pretendimeve që Presidenti i Republikës i parashtroi Gjykatës Kushtetuese, që prej datës 1 korrik 2021, e në vijim, duke kërkuar shqyrtimin e shpejtë të kësaj çështjeje.

Këto pretendime të Presidentit të Republikës ishin të bazuara mbi aktet shkresore që ishin administruar si pjesë e dosjes gjyqësore, përcjellë nga Gjykata Kushtetuese, por dhe nga shqyrtimi i praktikës parlamentare, të diskutimeve dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Shqipërisë lidhur me seancën plenare të datës 7 maj 2021<sup>1</sup>, dhe të mbështetura në provat konkrete, pra akteve të veprimtarisë parlamentare që vet Kuvendi i Shqipërisë ka publikuar<sup>2</sup> në faqen zyrtare të tij dhe që ju parashtruan e paraqitën Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim dhe debat gjyqësor, ku ndërmjet tyre renditej edhe aktet:

- **Urdhër nr. 19, datë 6.5.2021 i Kryetarit të Kuvendit, nr.1110 prot., datë 6.5.2021** “Për mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë **07.05.2021, ora 10.00**”, si dhe bashkëlidhur tij dokumenti “Rendi i Ditës i Seancës Plenare” që përmban çështjet, listën dhe aktet që shqyrtohen nga Kuvendi në seancë.

Këto akte janë depozituar në Gjykatën Kushtetuese dhe i janë bërë me dije asaj se janë nxjerrë nga faja zyrtare e internetit të Kuvendit të Shqipërisë, pikërisht në *link*-un:

<https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=6034>.

Kopje të printuara nga ky *link* të këtyre akteve, iu dorëzuan në cilësinë e provës Gjykatës Kushtetuese, që prej datës 1 korrik 2021, si akte që vërtetonin shkeljen e afateve dhe procedurave nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në procesin hetimor që kishin nisur ndaj Presidentit të Republikës.

Gjykata Kushtetuese, filloi dhe përfundoi shqyrtimin e kësaj çështjeje vetëm në muajin shkurt 2022, duke zhvilluar 3 seanca gjyqësore publike, respektivisht në datat **1, 3 dhe 7 shkurt 2022**, datë kjo kur u mbyll shqyrtimi gjyqësor.

**Në seancën e datës 3 shkurt 2022**, gjatë shqyrtimit gjyqësor, sipas procedurës u dëgjuan nga Gjykata, parashtrimet dhe pretendimet e Presidentit të Republikës, mbi kërkesën në tërësi të Kuvendit, dhe në veçanti mbi antikushtetutshmërinë dhe **shkeljet e rënda të procedurave parlamentare** të ndjekura nga Kuvendi i Shqipërisë në shqyrtimin e kërkesës së disa deputetëve për shkarkimin e Presidentit, dhe ngritjen e Komisionit të Posaçëm Hetimor parlamentar për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

**Në datën 3 shkurt 2022**, Gjykata Kushtetuese, pasi dëgjoi parashtrimet e përfaqësuesve ligjorë të Presidentit të Republikës dhe listoi një numër të konsiderueshëm pyetjesh për Institucionin e

---

<sup>1</sup> Konsultohuni me procesverbalet parlamentare të përmbledhura të publikuara për seancën e datës **7 maj 2021**  
<https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=6034>

Konsultohuni me praktikën parlamentare të caktimit të rendit të ditës për seancën e datës **7 maj 2021**  
<sup>2</sup> <https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=6034>

Presidentit të Republikës, për marrjen e përgjigjeve mbi to, caktoi si datën e vijimit të seancës publike, datën 7 shkurt 2022, ditë e hënë, ora 10:00, datë në të cilën do duhet të paraqiteshin dhe përgjigjet me shkrim nga Presidenti, mbi pyetjet e Gjykatës Kushtetuese.

Ndërkohë, vetëm një ditë më pas, pra në datën **4 shkurt 2022, ditë e premte**, rreth orës 15:30, në përfundim e sipër të orarit zyrtar të punës, Gjykata Kushtetuese, përmes shkresës me nr. 6 (K) 2021 Regj. Them., datë 4.02.2022 (protokolluar pranë nesh me nr. prot. 496, datë 4.02.2022), na vuri në dispozicion zyrtarisht shkresën me nr. 1368/15 prot., datë 4.02.2022 dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj, të depozituar në Gjykatën Kushtetuese po atë ditë nga Kuvendi i Shqipërisë, si provë të re shtesë për çështjen në shqyrtim (*kopje e kësaj shkrese dhe akteve shoqëruese gjenden bashkëlidhur*).

## **II. Rrethanat e çështjes dhe faktet për të cilat kërkohet ndërmarrja e veprimeve verifikuese dhe hetimore nga ana e organit të prokurorisë**

Pas studimit të dokumentacionit që Kuvendi i Shqipërisë i kishte depozituar Gjykatës Kushtetuese, në datë 4.02.2022, u konstatuan të dhëna shumë shqetësuese që tregojnë më së paku, për ndërhyrje apo përshtatje të akteve të brendshme administrative të Kuvendit, duke manipuluar elementë të aktit dhe përmbajtjen e tij, të cilat na krijojnë bindjen e palëkundur se, po realizoheshin me qëllim përshtatjen e këtyre akteve në funksion të mbështetjes së pretendimeve prej Kuvendit, për rrëzimin e kërkimeve të Presidentit të Republikës.

Kjo bindje u thellua edhe më tej, kur në seancën gjyqësore publike të datës 7.2.2022, ora 10:00, të zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese, një prej përfaqësuesve të Kuvendit të Shqipërisë, deputetja zonja Klotilda Bushka, pas çeljes së seancës gjyqësore, parashtrori përpara Gjykatës Kushtetuese se, provat e reja të depozituara me shkrim nga Kuvendi në datën 4.2.2022, hidhnin poshtë të gjitha pretendimet e Presidentit të Republikës, mbi shkeljen e Rregullores së Kuvendit për caktimin e rendit të ditës dhe miratimin e dy vendimeve nga Kuvendi në seancën plenare të datës 7.5.2021, që u finalizua me ngritjen e Komisionit Hetimor ndaj Presidentit.

Ndërkohë që, po në këtë seancë gjyqësore të datës 7.02.2022, përfaqësuesit ligjorë të Presidentit të Republikës, menjëherë parashtruan në mënyrë të detajuar dhe i faktuan Gjykatës Kushtetuese, të gjitha konstatimet, parregullsitë dhe mospërputhjet e dokumentacionit shkresor të vet Kuvendit të Shqipërisë, në krahasim si ndërmjet vet përmbajtjes midis dy akteve shkresore të depozituara nga Kuvendi në Gjykatën Kushtetuese në datën 4.02.2022 (Urdhri i Kryetarit të Kuvendit dhe Rendi i Ditës i Seancës Plenare datë 7.05.2021), ashtu dhe midis akteve shkresore të depozituara si provë e re në Gjykatë me aktet e publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit, që prej muajit maj 2021.

Për të gjitha parregullsitë, ndërhyrjet, dhe ndryshimin që paraqisnin këto akte si në elementët e aktit por dhe në përmbajtjen e tyre, që qartësisht dhe me sy të lirë evidentojnë manipulimin e përmbajtjes së tyre, përfaqësuesit ligjorë të Presidentit i kërkuan Gjykatës Kushtetuese në seancën gjyqësore të datës 7.02.2022, veç të tjerave që, të marrë në shqyrtim më shumë kujdes këto akte dhe të verifikojë vërtetësinë e këtyre provave të reja.

Duke qenë se këto fakte të konstatuara janë shumë të rënda dhe tregues i qartë dhe flagrant i ndërhyrjes në dokumentet shtetërore, rrjedhimisht e lidhur kjo edhe me qëllimin e realizimit të tyre, nuk mund të kemi të bëjmë me gjë tjetër përveç se me elementë të konsumimit të figurës së veprës penale **“Falsifikim i dokumenteve”**, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Presidenti i Republikës, mbart detyrimin dhe ia vendos në dispozicion të njëjtat fakte organit të ndjekjes penale me qëllim që të fillojë pa vonesë hetimin penal për zbardhjen tërësore të kësaj veprimtarie të paligjshme, për të zbardhur mekanizmin, kohën, personat e përfshirë, që si qëllim të tyre duket qartë se kanë patur shtrembërimin e fakteve, nga njëra anë për të mbuluar shkeljet e rënda procedurale të kryera nga Kuvendi i Shqipërisë në një proces fiktiv politik për shkarkimin e Presidentit të Republikës, dhe nga ana tjetër për t'i përshtatur ato në funksion të prapësimeve që Kuvendi paraqiti.

Në kushtet kur, këto akte kanë dalë nga Kuvendi i Shqipërisë, për pasojë edhe rrethi i zyrtarëve publikë/shtetërorë që mund të jenë përfshirë në këtë veprimtari të paligjshme, mund të shtrihet përtej nëpunësve të administratës, deri dhe tek funksionarët apo ish funksionarë politikë (deputetë apo ish-deputetë) që mund të jenë përfshirë në komprometimin e dokumenteve shpresore dhe qëllimit të keqpërdorimit të tyre, këto do të duhet të zbardhen nga hetimet e organit të ndjekjes penale.

Ndaj për këto arsye, kjo shkresë i përcillet si Prokurorisë së Posaçme (SPAK), ashtu edhe Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Të nderuar zonja/zotërinj Prokurorë,**

**1.** Siç dhe jeni në dijeni, sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, ky i fundit mbart detyrimin kushtetues që të informojë realisht publikun e gjerë për gjithë veprimtarinë dhe aktet parlamentare. Për këtë arsye, po sipas Rregullores së Kuvendit, gjithë aktet mbi veprimtarinë dhe vendimmarrjen e tij duhet t'i publikojë në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.

Në këtë faqe, për çdo veprimtari por dhe për çdo seancë plenare, publikohet jo vetëm çdo akt i depozituar, por deri në aktet e brendshme, duke filluar që nga urdhri i Kryetarit të Kuvendit për përcaktimin e rendit të ditës së seancave plenare, vetë rendi i ditës, përmbajtja e projekt-akteve

dhe veprimtaria e komisioneve respektive (procesverbale, vendime, raporte etj.). Publikimi i rendit të ditës, çështjeve për shqyrtim dhe akteve që shqyrtohen, janë detyrim për Kuvendin.

2. Nga praktika parlamentare e publikuar *online*<sup>3</sup>, rezulton i botuar dhe Urdhri nr. 19, datë **6.5.2021**, i Kryetarit të Kuvendit, lidhur me seancën plenare të datës **7 maj 2021**. Duke qenë se Kuvendi publikon çdo akt për thirrjen e seancës plenare (përfshirë Urdhrin përkatës për thirrjen e saj dhe përcaktimin e rendit të ditës së seancës), **edhe në këtë rast, për Seancën Plenare të datës 7 maj 2021, është vepruar po njësoj.**

3. **Urdhri nr. 19, datë 6.5.2021 i Kryetarit të Kuvendit, me nr. 1110 prot., datë 6.5.2021** “Për mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë 07.05.2021, ora 10.00”, si dhe bashkëlidhur rendi i Ditës i Seancës Plenare Publike për aktet që shqyrtohen nga Kuvendi në këtë seancë, është nxjerrë nga faqja e Kuvendit, në *link*-un:

<https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=6034>.

4. Ndërkohë që Kuvendi edhe pse e kishte publikuar këtë akt prej muajit maj 2021, në gjykimin kushtetues, pasi u njoh në datën 3.02.2022, me parashtrimet e Presidentit të Republikës, dhe pyetjet që Gjykata Kushtetuese i drejtoi Presidentit, menjëherë në mënyrë të habitshme, të pa kërkuar nga asnjë prej palëve, as nga vetë Gjykata, u vetë aktivizua dhe siç rezulton me shkresën nr. 1368/15 prot., datë 4.2.2022 (një ditë pas zhvillimit të seancës gjyqësore publike) depozitoi në Gjykatën Kushtetuese, prova shtesë ku **përfshihej kopje e njehsuar e:**

**- Urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr.19, datë 05.05.2021, me Nr. 1110 prot., datë 06.5.2021, si dhe bashkëlidhur tij Rendi i Ditës së Seancës Plenare të datës 7 maj 2021.**

Shkresa përcjellëse e Kuvendit nr. 1368/15 prot., datë 04.2.2022, është e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

5. Në një krahasim mes dy dokumenteve, (*Urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr.19*), pra urdhrit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit që në maj 2021, jo thjesht në format *PDF* elektronik, por i skanuar në formën e tij të nënshkruar dhe vulosur nga ish-Kryetari i Kuvendit, z.Gramoz Ruçi, në raport me kopjen e urdhrit që u depozitua nga Kuvendi si provë shkresore pranë Gjykatës Kushtetuese, në datën 4.02.2022, evidentohen me sy të lirë dallime shumë të dukshme.

Më konkretisht, mes këtyre dy versioneve të aktit rezultojnë qartë disa ndërhyrje që ngrenë **dyshime të forta për manipulim/ndërhyrje të këtij dokumenti.**

---

<sup>3</sup> Konsultohuni me procesverbalet parlamentare të përmbledhura të publikuara për seancën e datës 7 maj 2021 <https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=6034>



6. Konkretisht, dallimet që janë tepër të qarta e të dukshme, për lehtësinë tuaj, po i citojmë:

1) **Ka ndryshime të dukshme në datën** e urdhrit nr. 19, të Kryetarit të Kuvendit.

Në praktikën e publikuar *online* në maj 2021, urdhri nr. 19 i Kryetarit të Kuvendit, mban datën **06.05.2021**, (si në datën e protokollimit, ashtu edhe poshtë numrit të urdhrit).

Ndërkohë që në praktikën që në mënyrë të pa kërkuar është depozituar shkresërisht nga Kuvendi në Gjykatën Kushtetuese në datën 4.2.2022, Urdhri nr. 19, i Kryetarit mban **dy data**:

- **mban datën 05.05.2021**, në krah të numërtimit të Urdhrit, dhe
- **mban datën 6.05.2021, në krye të tij.**

Pra, lehtësisht dhe me sy të lirë, konstatohet:

- një ndërhyrje tek data e urdhrit, në raport me aktin e publikuar *online*;
- një datë e ndryshme brenda të njëjtit akt, në versionin e përcjellë si kopje e njehsuar pranë Gjykatës Kushtetuese.

2) Mes urdhrit të publikuar *online*, dhe atij të përcjellë Gjykatës Kushtetuese, **ka ndryshime të dukshme sa i takon përmbajtjes së pikës 20**, të Urdhrit nr. 19, të Kryetarit të Kuvendit.

Përmbajtja e pikës 20, të Urdhrit nr. 19, i referohet pikërisht çështjes që do të shqyrtohej në datën 7 maj 2021, që lidhej me procedurën e shkarkimit të Presidentit.

Por përmbajtja e pikës 20 të urdhrit të kryetarit të Kuvendit, dukshëm ndryshon thelbësisht mes dy dokumenteve. Konkretisht:

- a) Në Urdhrin nr. 19, datë 06.05.2021, publikuar në faqen e Kuvendit të Shqipërisë, pika 20 ka këtë përmbajtje:

*“Projektvendim “Për miratimin e raportit dhe propozimit të komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ngritjen e një komisioni hetimor, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra e Presidentit të Republikës”.*

Kjo përmbajtje e pikës 20 përputhet me dokumentin shoqërues “Rendi i ditës së seancës plenare të datës 7.5.2021”, si të këtij dokumenti të rendit të ditës të publikuar *online*, ashtu dhe të dokumentit “Rendi i ditës”, të depozituar shkresërisht në gjykatë në datë 4.02.2022.

- b) Ndërkohë që, pika 20 e Urdhrit nr. 19, datë **05.05.2021** (?!), i paraqitur si provë shtesë nga Kuvendi me shkresën nr. 1368/15 prot., datë 04.02.2022, përcjellë pranë Presidentit nga Gjykata Kushtetuese, ndryshon dhe ka këtë përmbajtje:

*“Projektvendim “Për raportin dhe propozimin e komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ngritjen ose mos ngritjen e një komisioni hetimor, për shkarkimin nga detyra e Presidentit të Republikës”.*

Qartësisht dhe me sy të lirë është e dallueshme se, në këtë urdhër që Kuvendi u kujtua t`ia dërgojë Gjykatës Kushtetuese në formë shkresore në datën 4.02.2022, pa iu kërkuar, është hequr fjala “miratim”, fjala “raportit” është zëvendësuar me fjalën “raportin”, fjala “propozimit” është ndryshuar me fjalën “propozimin”, lidhëza “të”, është zëvendësuar me lidhëzën “e”, pas fjalës “ngritjen”, është shtuar fjala “ose mos ngritjen”, dhe togfjalëshi “bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh”, është hequr fare.

**Të gjitha këto ndërhyrje që mund të duken si saktësime gjuhësore, në fakt tentojnë të ndryshojnë jo vetëm përmbajtjen e aktit, por mbi të gjitha të justifikojnë mënyrën e vendimmarrjes së Kuvendit, në shkelje të legjislacionit në fuqi, për këtë çështje në seancën plenare të datës 7.05.2021. Pra për të justifikuar nxjerrjen e dy vendimeve të njëkohshme nga Kuvendi, brenda të njëjtës seancë, pa i patur të parashikuara.**

3) Ndërkohë që, nëse e krahasojmë përmbajtjen e Urdhrit nr. 19, datë 05.05.2021, që Kuvendi, i ka paraqitur si provë shkresore shtesë Gjykatës Kushtetuese, në datën 4.02.2022, rezulton se vet përmbajtja e këtij urdhri, siç evidentuam më sipër, **nuk përputhet as me dokumentin e rendit të ditës që po në formë shkresore shoqëron këtë praktikë të depozituar në Gjykatën Kushtetuese.**

Kjo pasi në dokumentin “Rendi i Ditës”, në variantin që e printuar shoqëronte Urdhrin dhe përcjellë shkresërisht në formë të njehsuar nga Kuvendi në datë 4.02.2022, citohet se:

“Në mbështetje të Urdhrit nr. 19, datë **06.05.2021** të Kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, rendi ditës është si më poshtë vijon:

*“20. “Projektvendim “Për miratimin e raportit dhe propozimit të komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ngritjen e një komisioni hetimor, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra e Presidentit të Republikës”.*

Pra edhe brenda të njëjtës praktikë shkresore që Kuvendi i paraqet Gjykatës Kushtetuese në datë 4.02.2022, në cilësinë e provës, nuk **përputhen praktikat shoqëruese, gjë e cila faktori dhe e nxjerr zbuluar atë (Kuvendin) për ndërhyrjet që ka bërë në akt, kur:**

- a) as vetë data e urdhrorit që referohet në dokumentin “Rendi i Ditës” bashkëlidhur, nuk përputhet me datën që mban kopja shkresore e urdhrorit të Kryetarit të Kuvendit që vet Kuvendi ka sjellë si provë shkresore përpara Gjykatës (në rend dite nuk referohet data 5 maj 2021, por data **6 maj 2021**); ashtu si kundër
- b) nuk përputhet as përmbajtja e pikës 20 të urdhrorit për thirrjen e seancës plenare që Kuvendi i depozitoi Gjykatës Kushtetuese në datë 4.02.2022, me pikën 20 të dokumentit “Rendi i Ditës”, që po shkresërisht ia depozitoi Gjykatës si provë të re.

7. Për më tepër, i duhet rikujtuar Gjykatës Kushtetuese se, Komisioni për çështjet ligjore u mblodh dhe miratoi Raportin e tij që ia përcolli Seancës Plenare, vetëm në datën **6 maj 2021**.

Ndaj **nuk ka se si Kryetari i Kuvendit, me urdhër të hartuar që në datën 5 maj 2021 (?), për caktimin e rendit të ditës, të dinte se si do të procedonte Komisioni për çështjet ligjore në datën 6 maj 2021!!**

Ky fakt është tregues i qartë se versioni i saktë i Urdhrit të Kryetarit të Kuvendit, mban datën 6 maj 2021 dhe është ai i publikuar në faqen zyrtare të Internetit të Kuvendit, me firmë dhe vulë.

Kjo u pranua dhe nga përfaqësuesit e Kuvendit në seancën gjyqësore publike të datës 7.2.2022 përpara Gjykatës Kushtetuese, pasi u pyet disa herë nga anëtarët e trupës gjyqësore.

Kurse kopja e përcjellë pranë Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi në datën 4.02.2022, është qartazi **e manipuluar**, me qëllimin e vetëm për të mbuluar shkeljet procedurale që ka kryer Kuvendi duke mos respektuar afatin 2 ditor<sup>4</sup> të bërjes publike të Rendit të Ditës, e normalisht edhe të dokumenteve që do të shqyrtoheshin në Seancën Plenare, dhe duke pretenduar se Seanca Plenare e datës 7 maj 2022, në fakt ishte thirrur sipas rregullit- 2 ditë më herët, në datën 5 maj 2022, dhe jo në datën 6 maj 2022.

Kryetari i Kuvendit, jo vetëm që nuk kishte mundësi të dinte vendimmarrjen e Komisionit për çështjet ligjore, e për pasojë që në datën 5 maj 2021, të arrinte të përcaktonte rendin e ditës, por edhe në eventualitetin e një përcaktimi të koordinuar për shkak të situatës së diktuar politikisht, Kuvendi në çdo rast, ka kryer shkelje të Rregullores së Kuvendit.

Nga kjo mënyrë veprimi e Kuvendit, arrijmë në bindjen se, duke ja vënë në dispozicion këto akte Gjykatës Kushtetuese, dhe në rast se përfaqësuesit e Presidentit të Republikës nuk do t'i vinin re këto ndryshime, dhe nuk do t'i kundërshtonin ato në Gjykatë, atëherë Kuvendi përmes dhe

---

<sup>4</sup> **Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, në nenin 27, pika 5, përcakton se:**

“Në çdo rast, rendi i ditës duhet të jetë bërë publik të paktën **2 ditë** përpara datës së caktuar për mbledhjen e komisionit, ose seancës plenare”.

propagandës politike, synonte ta keq orientonte Gjykatën Kushtetuese me akte që si në formë, ashtu dhe në elementë e në përmbajtje, nuk përmbanin të dhëna të sakta, fakte këto që mund të keq orientonin shqyrtimin e çështjes prej Gjykatës Kushtetuese me të dhëna të pasakta.

Sa më sipër, këto veprime konsiderohet tepër të rënda, që përfshijnë deri veprime të manipulimit të provave që i depozitohen Gjykatës Kushtetuese e që ndryshojnë përmbajtjen e akteve zyrtare për të mbuluar shkeljet procedurale të konsumuara gjatë procesit.

### **III. Mbi analizën ligjore të fakteve dhe veprimeve që përmbushin elementët e figurës së veprës penale të konsumuar, si dhe mbi autorët e mundshëm**

Të gjitha faktet e mësipërme, janë tregues i konsumimit të veprës penale parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikim i dokumenteve”.

#### **1. Mbi elementët e figurës së kësaj vepre penale**

Realizimi i funksioneve dhe detyrave të shtetit të së drejtës kërkon që e tërë veprimtaria e aparatit të tij të ushtrohet mbi bazën e dokumenteve zyrtare të rregullta e të vlefshme.

Në qoftë se në dokumentet pasqyrohen rrethana që nuk i përgjigjen së vërtetës apo bëhen ndryshime në to, quhen të falsifikuara. Me falsifikim të dokumenteve kuptojmë paraqitjen në të, të rrethanave të rreme ose përpilimin e një dokumenti krejtësisht të falsifikuar si dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara.

**Objekt** i krimit të falsifikimit të dokumenteve apo të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të administratës publike, të organizatave, ndërmarrjeve, firmave, shoqatave etj., të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Nga falsifikimi i dokumenteve mund të preken interesat e ligjshme të shtetit dhe të shtetasve.

**Objekt material** i krimit mund të jenë dokumentet zyrtare apo private të ndryshme.

**Nga ana objektive** krimi i falsifikimit kryhet në dy forma kryesore:

- a) me anë të falsifikimit të dokumenteve, ndryshimit të të dhënave që ato përmbajnë;
- b) me përdorimin e dokumenteve të falsifikuara.

**Falsifikimi i dokumenteve bëhet me:**

- a) **Paraqitjen në dokumente zyrtare të rrethanave ose ta dhënave që dihen se janë të rreme, nuk i përgjigjen të vërtetës;**
- b) Përpilimin ose **dhënien e një dokumenti zyrtar krejtësisht të falsifikuar;**

c) Falsifikimin e dokumentit të shtetasit që ndodhet në një zyrë shtetërore, ose organizate etj.;

Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve nuk kërkon si element të saj qëllimin e fitimit, por mjafton që të pasqyrohen në to të dhëna të pavërteta.

**Subjekt** i krimit të falsifikimit të dokumenteve, mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, i cili falsifikon dokumentin.

**Nga ana subjektive** krimi i falsifikimit të dokumenteve apo përdorimit të dokumenteve të falsifikuara kryhet **vetëm me dashje direkte**. Personi e di që paraqet rrethana të rreme në një dokument, apo falsifikon dokumentin (zyrtar apo privat) dhe dëshiron një gjë te tillë.

**Motivi** dhe **qëllimi** nuk janë elemente të domosdoshëm përbërës të figurës së krimit. Ato mund të jenë të ndryshëm (interesi, qëllimi, fitimi personal etj.), por nuk kanë ndonjë rëndësi për cilësimin juridik të krimit.

**Krimi i falsifikimit të dokumenteve konkurron me krimin e shpërdorimit të detyrës.**

## **2. Mënyra dhe veprimet që kanë çuar në konsumimin e elementëve të kësaj vepre penale dhe autorët:**

Faktet që po referohen pranë organit të ndjekjes penale, tregojnë se të gjitha veprimet e kryera, përmbushin të katërt elementët e figurës së veprës penale të kallëzuar.

Konkretisht:

- Lidhur me **objektin** dhe **anën objektive**, jemi para rastit kur pranë Gjykatës Kushtetuese janë depozituar dokumente zyrtare, përmbajtja e të cilave nuk përputhet me përmbajtjen e të njëjtave akte, si shkresore dhe të publikuara *online*.
- Nuk bëhet fjalë për një dokument të vetëm, por për disa:
  - (i) Urdhër i Kryetarit të Kuvendit me nr. 19, i vitit 2021;
  - (ii) Rendi i ditës së Seancës Plenare të datës 7 maj 2021, që ndryshon në përmbajtje sa i përket çështjes me nr. 20 në këtë rend dite me Urdhër të Kryetarit të Kuvendit nr. 19, datë 05.05.2021 të depozituar shkresërisht;

(iii) Vetë shkresa përcjellëse e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, me nr. prot. 1368/15, datë 4.02.2022, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera citon se:

*“Në lidhje me shqyrtimin e çështjes me objekt “Shkarkimin e Presidentit të Republikës për shkelje të rënda të kushtetuese”, Kuvendi ju vë në dispozicion:*

*1- Urdhri nr. 19, datë 05.05.2021, për mbledhjen e Kuvendit në Seancën plenare në datë 7.05.2021 (dy fletë)*

*2- Rendin e ditës së seancës plenare të datës 7.05.2021 (pesë) fletë;[...]*”

thekson kështu se ky Urdhër **mban datën 05.05.2021**. Kjo vërteton konsistencën dhe qëllimin për ta keq orientuar Gjykatën Kushtetuese, drejt një fakti (pra të një date) jo të saktë.

- Për më tepër, ky akt (Urdhri nr. 19, i Kryetarit të Kuvendit), në kopjen e dorëzuar Gjykatës Kushtetuese, e që përmban dhe siglat e personave që e kanë punuar, është gjithsej 2 faqe.

Ndërkohë që, i njëjti akt i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit, në format PDF, të skanuar, me vulën e nënshkrimit të Kryetarit të Kuvendit, është 3 faqe.

Ky fakt është një tregues më shumë se, përmbajtja e këtij akti është **manipuluar me qëllim**, pasi rregullat e administrimit të qarkullimit të dokumentacionit të brendshëm në administratën publike, kërkojnë që të gjitha kopjet e të njëjtit akt të brendshëm të jenë të njëjta, pa asnjë ndryshim, as në formë as në përmbajtje, përveç faktit se, kopja që qëndron në arkiv-protokollin e institucionit, duhet të ketë dhe siglat e personave që e kanë hartuar dhe përmes të cilëve është qarkulluar akti deri në miratimin përfundimtar të tij.

- Marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të administratës publike, qartazi janë cenuar dhe dëmtuar rëndë, duke tentuar edhe cenimin e objektivitetit të një procesi që zhvillohej para Gjykatës Kushtetuese.
- Nga **ana objektive**, figura e veprës penale të falsifikimit është konsumuar në të dyja format:
  - a) si me anë të ndryshimit të të dhënave që ato përmbajnë; ashtu edhe
  - b) me përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, duke ia depozituar për dezinformim vetë Gjykatës Kushtetuese.
- Në aktet e sipërcituara, dokumente zyrtare të një prej institucioneve më të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë, ndërhyrja është kryer duke paraqitur të dhëna që **nuk tregojnë as kohën e vërtetë** (referuar ndryshimit të datës) dhe **as përmbajtjen e vërtetë të akteve** (referuar ndryshimit të pikës nr. 20 të urdhrin lidhur me çështjen e rendit të ditës së Seancës Plenare të datë 7.05.2021).

- Lidhur me **subjektin** e kësaj vepre penale, personat e përfshirë do të duhet të evidentohet nga hetimi penal që do të kryejë organi i prokurorisë, jo vetëm brenda hierarkisë administrative të Kuvendit, por edhe deri mes deputetëve që kanë ndjekur çështjen që është bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese, apo funksionarë apo ish-funksionarë të lartë të Kuvendit që mund të jenë përfshirë, përdorur, apo që mund të kenë diktuar, **duke ushtruar ndikim të paligjshëm** mbi administratën e Kuvendit, për konsumimin e kësaj veprimtarie të paligjshme.

Pra përmes hetimit penal dhe deklarimeve të personave përgjegjës në Kuvend, mund të evidentohen dhe vepra penale të tjera, të tilla si “**Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike**”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

Për këto arsye, ky kallëzim paraqitet si pranë Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, ashtu edhe pranë Prokurorisë së Posaçme (SPAK), në mënyrë që në varësi të rrethit të subjekteve të përfshirë, të procedohet sipas kompetencave respektive të tyre në kryerjen e këtij hetimi penal.

- Lidhur me **anën subjektive**, veprimet e mësipërme vlerësohet se janë kryer me dashje, me qëllimin e vetëm për të dezinformuar Gjykatën Kushtetuese dhe për të paraqitur pranë kësaj gjykate sikur Kuvendi, për çështjen objekt shqyrtimi, kishte respektuar afatet procedurale sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo me qëllim për të tentuar rrëzimin e kërkimeve kushtetuese dhe të faktuara të pretendimeve të Presidentit të Republikës para Gjykatës Kushtetuese, për shkelje flagrante të procedurës nga ana e Kuvendit.

#### **IV. Konkluzione**

Sa më sipër, Presidenti i Republikës, iu referon këto fakte, shoqëruar me dokumentet shkresore që disponon, për të kryer pa vonesë verifikimet dhe hetimet përkatëse, jo vetëm për të parandaluar manipulimin e mëtejshëm të akteve zyrtare të Kuvendit, e që çojnë në dezinformimin e publikut dhe institucioneve të tjera shtetërore, por edhe për të vënë para përgjegjësisë penale të gjithë personat e përfshirë, në të gjitha nivelet hierarkike administrative të Kuvendit të Shqipërisë.

Rëndësia e shpejtësisë së këtyre veprimeve, rritet dhe më shumë, kur jemi para faktit se janë konsumuar veprime që përbëjnë vepër penale nga punonjës me detyra të larta shtetërore, e kur nuk është hezitur që këto akte me përmbajtje të ndryshuar, t’i dorëzohen edhe Gjykatës Kushtetuese për një çështje në shqyrtim përpara saj.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, për të njëjtat fakte si më sipër, gjatë seancës gjyqësore publike të mbajtur në datën 7.02.2022, në Gjykatën Kushtetuese, përfaqësuesit e Kuvendit kanë dhënë

komentet e tyre. Thëniet e tyre gjatë seancës, mund të merren nga organi i akuzës në cilësinë e provës, për t'u vlerësuar në raport me çfarë do të evidentohet nga dokumentacioni shkresor dhe veprime të tjera hetimore që do të ndërmerri.

### **Bashkëlidhur do të gjeni:**

- Kopje të njehsuar të shkresës nr. 6 (K) 2021 Regj. Them., datë 4.02.2022, të Gjykatës Kushtetuese që përmban bashkëlidhur:
  - a) kopje e shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë nr. 1368/15 prot, datë 04.02.2022;
  - b) kopje të dy prej akteve që referohen në këtë shkresë (i) Urdhri nr. 19, datë 05.5.2021, të Kryetarit të Kuvendit, nr.1110 prot., datë 6.5.2021 *“Për mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë 07.05.2021, ora 10.00”*, dhe (ii) dokumenti *“Rendi i Ditës i Seancës Plenare të datës 07.05.2021”*;akte këto të dërguar prej Gjykatës Kushtetuese dhe të administruara në Institucionit të Presidentit të Republikës me nr. prot. 496, datë 4.02.2022; dhe
- Kopje të printuar nga faqja zyrtare<sup>5</sup> e Kuvendit të Shqipërisë, të këtyre dokumentave:
  - a) Urdhri nr. 19, datë 6.5.2021, i Kryetarit të Kuvendit, nr.1110 prot., datë 6.5.2021 *“Për mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë 07.05.2021, ora 10.00”*; dhe
  - b) Dokumenti *“Rendi i Ditës i Seancës Plenare të datës 07.05.2021, ora 10:00”* bashkëlidhur.

**Me konsideratë,**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

**ILIR META**

---

<sup>5</sup> Këto akte janë printuar nga faqja zyrtare e internetit të Kuvendit të Shqipërisë, në *link*-un:

<https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=6034>.

Ato gjithashtu mund të gjenden në seksionin e faqes zyrtare të këtij institucioni, ku renditen Seancat Plenare sipas datës të zhvillimit të tyre.